Siguria e kartelave bankare

Kartela bankare është instrument pagese qe i mundëson klientit qasje 24/7 në mjetet e tij financiare për të kryer pagesa apo realizuar tërheqje/deponime ne bankomatë.

Për transaksionet në bankomat dhe pika te shitjes (POS) klienti identifikohet përmes PIN-it qe vendos gjate realizimit te transakcionit përderisa për transaksionet në internet respektivisht blerjet online klienti duhet te shpalos disa informata te rëndësishme si emri dhe mbiemri, numrin e kartelës, datën e skadencës së kartelës si dhe numrat e sigurisë që gjenden pas kartelës.

Andaj me qellim te parandalimit te keqpërdorimeve eventuale, është shume e rëndësishme që kartela dhe PIN-i të mbahen në vende të sigurta dhe të përdoren me kujdes.

Shpalosja e informatave te kartelës

Ne asnjë mënyrë informatat e kartelës dhe PIN-i nuk duhen t'iu shpalosen palëve te tjera.

Punëtorët e bankës pavaresisht pozitës, ne asnjë forme nuk kërkojnë informatat e kartelës dhe kodet e sigurisë për transaksionet me kartela.

Informatat ne vijim ne asnjë mënyre nuk duhet te ndahen me pale tjera përmes emailit, telefonit, pop up mesazhit ne rrjete sociale dhe kanaleve tjera:

- *Numri i kompletuar i kartelës*
- *Afati i skadimit te kartelës (Muaji dhe Viti)*
- *Kodi 3 shifror mbrapa kartelës (CVV2)*
- *PIN i kartelës*
- *Kodi një përdorimesh qe pranoni ne telefonin tuaj përmes SMS, qe përdorët për blerje online (3D Secure kodi)*

Gjitha këto informata, si dhe informata tjera plotësuese janë personale dhe nuk duhet te ndahen me dike tjetër, ashtu siç edhe nuk duhet te ndahet kartela me pale te tjera. Informatat dhe kartelat e bankës janë personale dhe ndarja e tyre, hap rruge për keqpërdorim eventual te kartelës.

Rekomandime për transaksionet me kartela ne internet

Krahas digjitalizimit te shërbimeve te ndryshme, edhe numri i transaksioneve online me kartela ka shënuar rritje. Rrjedhimisht tentimet për keqpërdorime te kartelave po ndodhin kryesisht ne këto lloj pagesash, ku është me e lehte për keqpërdoruesit te bëjnë një gjë te tille.

Andaj rekomandohet qe për këtë lloj te transakcioneve ti kushtohet kujdes me i larte ne veçanti pikave ne vijim:

- *Kontrolloni nëse ueb faqja ku tentoni te bëni pagesën është valide duke bere gjurmim ne internet për te dhe analizuar komentet tjera*
- *Kontrolloni nëse ueb faqja përdorë parametrat e sigurisë si p.sh. nëse adresa fillon me "https"*
- *Sigurohuni të kryeni blerje tek tregtarë e pajisur me shërbimin 3D Secure dhe kontrolloni nëse ueb faqja i ka logot zyrtare te VISA dhe MasterCard*
- *Bëni gjithmonë mbylljen e faqes se tregtarit pas kryerjes së transaksionit të blerjes*

Adresa:
Rr. Ukshin Hoti, Nr. 128, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 620 620
Qendra e thirrjeve: 0800 50 000
informata@bpbbank.com
www.bpbbank.com

- *Beni kujdes për anëtarësimet ne ueb faqe te ndryshme, kujdesuni qe te dhënat te mos ruhen, si dhe mos bëhen anëtarësime automatike*
- *Mos ndani përmes telefonit apo kanaleve sociale (Facebook, Viber, Whatsapp etj.) informatat e kartelës tuaj*
- *Evitoni ekspozimin e të dhënave të kartelës në kompjuterë publik*

Rekomandime për transaksione me kartela ne POS terminale

Gjate realizimit te transakcionit ne POS, shmangni dorëzimin e kartelës te shitësi dhe tentoni te jeni afër gjate procesimit te transakcionit sidomos ne rastet ku kartela tentohet te lexohet përmes shiritit magnetik. Sigurohuni te përdorni mënyrën e pageses me rreze (contactless) për te evituar nevojën e dorëzimit te kartelës.

Gjate realizimit te ketyre transakcioneve rekomandohet:

- *Mbroni PIN-in nga vëzhgimi, duke vendosur dorën për ta mbuluar*
- *Mos lini kartelën jashtë vështrimit tuaj gjate blerjes*
- *Sigurohuni që kartela kalohet vetëm një herë*
- *Shmangni pagesat ku tentohet te lexohet shiriti magnetik*

Rekomandime për transaksione me kartela ne bankomate

Një nder funksionet kryesore te kartelës është tërheqja dhe deponimi ne bankomate. Përdorimi i kartelës në bankomat është një mënyrë komode dhe e thjeshtë për të marrë paratë andaj është shume e rëndësishme te sigurohuni që e bëni në mënyrën e duhur.

- *Bëni kujdes para se te futni kartelën në bankomat, duke kontrolluar për prani të ndonjë pajisjeje të huaj*
- *Nëse vëreni ndonjë pajisje te dyshimte te pjesa ku futet kartela, vendoset PIN-i apo tek kamera, menjëherë te telefonohet Qendra e Thirrjeve*
- *Në asnjë mënyrë mos kërkoni apo pranoni ndihme nga persona qe nuk i njihni gjate realizimit te transaksionit ne bankomat*
- *Mos shkruani PIN-in ne vende te qasshme apo edhe ne vet kartelën tuaj*
- *Mos përcaktoni PIN lehte tu qëlluar, sikur 1234 apo ditëlindja juaj / ndonjë familjari tuja meqë janë informata lehte te qasshme për keqpërdoruesit.*
- *Në rast se dyshoni se PIN-i juaj mund të jetë kompromentuar, njoftoni menjëherë Bankën dhe ndryshoni sa më shpejt PIN në ATM më të afërt*

Rekomandime tjera dhe informata shtese

- *Fishingu (phishing) nënkupton përdorimin e e-mail apo dritareve "pop-up" për të marr informatat personale të konsumatorit (Numri i letërnjoftimit, numri i pasaportës, etj) si dhe të dhënat e kartelës (numri i kartelës, datën e vlefshmërisë, kodin verifikues). Andaj duhet te behet kujdes maksimal sidomos nga rrjetet sociale qe ju ftojnë te bëheni pjese te lojërave te fatit, kampanjave qe premtojnë dhurata dhe/apo ngjarjeve tjera te natyrës se njëjte.*
- *Përdorni shërbimet digjitale te bankës si platformat E/Mbanking dhe kontrolloni ne baza ditore transaksionet tuaja me kartela*

Adresa:
Rr. Ukshin Hoti, Nr. 128, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 620 620
Qendra e thirrjeve: 0800 50 000
informata@bpbbank.com
www.bpbbank.com

- *Ne rast te dyshimeve, bllokoni menjëherë kartelën tuaj përmes E/Mbanking, Qendrës se thirrjeve apo përmes degës me te afërt*
- *Inkurajoheni te raportoni dhe kontestoni transaksionet qe nuk janë te njohura për ju, ne degën me te afërt apo përmes Qendrës se Thirrjeve. Banka do te shqyrtoj ankesën tuaj dhe do te inicioj procesin për kthim te mjeteve te keqpërdorura*

Adresa:
Rr. Ukshin Hoti, Nr. 128, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 620 620
Qendra e thirrjeve: 0800 50 000
informata@bpbbank.com
www.bpbbank.com